



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.05.2019,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

**Mungoi:** Blerand Stavileci.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues, me këtë**

### **REND DITE:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi - Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit dhe Xhafer Sinanit;**
- 3. Propozimvendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA në Prishtinë;**
- 4. Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të Projektregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;**
- 5. Të ndryshme.**

### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi - Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit dhe Xhafer Sinanit.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi - Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit dhe Xhafer Sinanit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA në Prishtinë.**

Agim Gashi tha se ndoshta është mirë që të formohet kjo ndërmarrje, megjithëse ka mundur me funksionuar edhe pa qenë ndërmarrje, sepse kështu ka ekzistuar edhe më parë, si kuzhinë e institucioneve parashkollore, por uroj të mos ndodh sikurse me "Prishtina Parking", të cilën e formuam dhe nuk po funksionalizohet, kjo besoj se funksionalizohet, sepse kësaj vetëm i ndërrohet statuti. Mirëpo do të duhej të ishte ndonjë person që na referon, që të kemi njohuri se çka kanë planifikuar nëse ajo shndërrohet në ndërmarrje komunale. Si kryesues i Komitetit, është mirë të kërkonim, ose të shkojmë si mesazh nga Komiteti, që në Kuvend të mos ndodh si në KPF, të mos jetë askush për prezantim, sepse dëshirojmë që për çdo planifikim ta dimë dhe të jemi bashkëpjesëmarrës në shtyrjen e proceseve për një gjë që planifikohet dhe për të vendoset në Kuvend.

Egzon Azemi u shpreh i pajtimit me zotëri Gashin për formimin e kësaj ndërmarrje, mirëpo shihet se te plani i biznesit, përveç që punësohen 5 persona, një menaxher, tre anëtarë bordi dhe një kontabilist, nuk ka asnjë ndryshim të punës në veprimtarin e saj, e nëse është funksionale në këtë mënyrë dhe çfarë kuptimi ka kjo ndërmarrje, të bëhet ndërmarrje publike, vetëm t'i shtohen shpenzimet për 4,5 anëtarë të tjerë.

Unë jam për themelimin e kësaj ndërmarrje, mirëpo duhet kërkuar që kjo ndërmarrje të ketë plane afatgjata, që mundësitë dhe veprimtaritë e kësaj ndërmarrje të jenë shumë të mëdha dhe

mundet me u krijuar një ndërmarrje shumë e suksesshme dhe me kapacitete edhe për punësim, dhe shërbime që mundën me iu ofruar në mënyra të ndryshme qytetit të Prishtinës.

Në bazë të këtij dokumenti që na është ofruar, këtu s'ka tjetër qëllim, por vetëm një pazar se si të ndahen ndërmarrjet, siç është "Prishtina Parking", që u përmend nga parafolësi, ka qe një vit që tentohet me u emëruar disa njerëz politikë aty dhe mua personalisht 3 - 4 herë më është dashur me u ankuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, që merret me monitorimin e këtyre ndërmarrjeve, ku shumicën e rasteve i ka kthyer si të kundërligjshme dhe sot po vazhdon prapë me qëndruar pa funksionuar kjo ndërmarrje, që është njëra ndërmarrjet më të rëndësishme, e cila i kishte zgjidhur problemet kryesore të qytetit të Prishtinës.

**Genc Sherifi** theksoi se pajtohet me atë që e tha zotëri Gashi, se duhet me na u ofruar më shumë informacione. Kjo ndërmarrje është shumë e nevojshme për qytetin e Prishtinës. Kam informacion se kjo ka me qenë një ndër ndërmarrjet më të suksesshme në Komunën e Prishtinës, siç janë duke funksionuar një pjesë e madhe e ndërmarrjeve që jemi duke i menaxhuar, kështu që është në rregull të kërkojmë prej ekzekutivit që në mbledhje me na dhënë informata më shumë për këtë ndërmarrje.

**Sami Boroci** e përkrahu themelimin e kësaj ndërmarrje. Ai tha se te pjesa që e ceku Emani, rritje e koston, po e shoh se është një pjesë e menaxhimit që duhet me ekzistuar dhe pajtohem, por nuk po e shoh të arsyesh pse me lejuar në këtë mënyrë me funksionuar. Është shumë më mirë me shndërruar në ndërmarrje publike lokale.

**Agim Gashi** tha se më parë kuzhina është quajtur "Kuzhina Qendrore".

**Osman Bllaca** theksoi se ajo është privatizuar nga "Beni Dona".

**Agim Gashi** bëri të ditur se nuk është privatizuar objekti, por shërbimi përcjellëse teknik, sepse Kosova nuk ka pasur kapacitet me rritur numrin e të punësuarve në arsim dhe gjithkund në botë këto gjëra janë të privatizuara, por ne po formojmë ndërmarrje komunale, e cila do të mund të rrisë kapacitetet deri në shkallën kur të arrihet një standard për mësimin gjithëditor në shkolla, furnizimin e kuzhinave shkollore dhe ajo duhet të jetë ekskluzive për nevojat e sistemit arsimor në komunën e Prishtinës, sepse ne duhet të bëjmë, marrim vendim afatgjatë, që do të mund të funksionojë sot e 20 vjet. Pra, kjo mungon në sqarim, sepse nuk mjafton vetëm një plan i biznesit aty me i shtuar 2 - 3 udhëheqës zyrtarë dhe me rritur një sasi mjetesh. Ajo bëhet me shpenzua, nuk bëhet me kursyer mjete, në atë kuptimin vëllimor, me i ngritur cilësitë në shërbimet përkatëse, dhe ne në të ardhmen nuk do t'i kemi 50 e më shumë kuzhina shkollore, se mësimi gjithëditor nënkupton të ushqyerit e fëmijëve brenda institucionit dhe qëndrimin e tij brenda institucionit. Kjo do t'i ndihmojë në atë fushë Komunës së Prishtinës, pavarësisht kush qeveris, prandaj qeveria duhet të japë sqarim rreth kësaj, cilat janë planet afatshkurtra dhe cilat janë planet afatgjata.

**Vala Peshku** tha se Kuzhina Qendrore, siç po shihet, është duke funksionuar për shkak se ekzekutivi ka pasur vizion, është duke i furnizuar edhe shujtat e nxehta për skamnorë. Në fillim të këtij dokumenti thuhet se, përgjatë periudhës së parashikuar në planin e biznesit, ndërmarrja



do t'i mbulojë shpenzimet e saj, deri tash Komuna vetëm e ka financuar, kjo është njëra ndër arsyet se kjo shndërrohet në ndërmarrje publike për të qenë e vetëmbajtur. Pajtohem se duhet pasur ndoshta një prezantim pak më të gjerë se çka mendohet me u bërë më tutje me këtë ndërmarrje. Duhet pasur parasysh se, përderisa nuk erdhi ky ekzekutiv, kjo kuzhinë thuhet ka qenë inekzistente, andaj është për t'u përshëndetur puna që po bëhet.

**Agim Kuleta, kryesues,** theksoi se në Kuvend sigurisht se do të vjen, do të bëhet prezantimi i sponsoruesit, por duhet me qenë edhe këtu.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të Projektregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës.**

**Medina Braha** dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim, duke cekur se qëllimi është me i rregulluar vendparkingjet në qytet, andaj i kemi ndarë në tri kategori: vend parkingjet publike, ku janë paraparë parkingjet që janë aktuale dhe që po mendohet të rregullohen ose me u menaxhuar nga "Prishtina Parking", janë PPP, që është parking nëntokësor, dhe parkingjet private aktuale, që i kemi paraqitur disa kritere, në mënyrë që mu rregulluar me një menaxhim siç duhet e jo siç janë tani, thuhet pa kurrfarë kriteri. Ky propozimvendim do të dalë në diskutim publik.

**Agim Gashi** parashtrori pyetje për drejtoreshën, se cilat janë planet për vitin 2019 në fushën e parkingjeve në aspektin e përgatitjes së infrastrukturës, si masë themelore për të mundësuar pastaj implementimin e kësaj rregulloreje.

Po ashtu, pyeti se a është hartuar kjo rregullore nga ekspertë dhe zyrtarë të Komunës, apo është kopjuar nga ndonjë model i ndonjë shteti të caktuar në Ballkan, më konkretisht nga cila gjuhë është përkthye.

**Medina Braha,** sa i përket pyetjes së parë për infrastrukturë, pyeti z. Gashi se a e ke fjalën për infrastrukturën rrugore të ne, apo infrastrukturën e parkingjeve.

**Agim Gashi** tha e kam fjalën për infrastrukturën e parkingjeve, cila është infrastruktura për parkingje.

**Medina Braha** pyeti se a është fjala për parkingje publike apo private.

**Agim Gashi** tha infrastruktura për parkingje nuk dallon pronësinë, por është standard që rregullon fushën e shërbimeve në parkingje, duke filluar nga rregullimi i hapësirave, shtrimi i tyre, kapaciteti i tyre, lloji i tyre, shenjëzimi i tyre, pastaj ka edhe disa karakteristika të tjera që i rregullon ligji përkatës, përkatësisht tash po e fuqizojmë rregulloren.

**Medina Braha** tha se te parkingjet private është paraparë që operatori privat ta rregullojë vend parkingun e vet në bazë të kriterëve që janë paraparë.

**Agim Gashi** pyeti se çka ka paraparë Komuna sivjet me buxhetin e saj.

**Medina Braha**, tha se për sivjet për parkingje nuk di që ka paraparë diçka Komuna, nuk kam ndonjë informatë për plane.

Sa i përket pyetjes së dytë, kjo rregullore është hartuar prej një komisioni, që ka pasur anëtarë prej DSHP-së, Zyrës ligjore, Inspeksionit dhe Urbanizmit. Ata i kanë analizuar ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare, dhe kanë ardhur deri te kjo rregullore. Nuk besoj që është përkthim.

**Agim Gashi** tha se kisha dëshiruar që drejtoritë përkatëse me i orientuar kapacitete e veta buxhetore dhe profesionale, në mënyrë që të fillohet me krijimin e kushteve për zbatimin e rregullores.

**Egzon Azemi** u shpreh se kam një pyetje për drejtoreshën, e pastaj kam për ta bërë një koment.

Pyetja është: Kur ka me filluar me u investuar në një parking të ri si Komunë e Prishtinës, sivjet apo vitin tjetër?

**Medina Braha** tha ndoshta sivjet, por nuk e kamë informatën e plotë.

**Egzon Azemi** bëri edhe komentin, duke thënë se ju jeni drejtoreshë e Shërbimeve Publike dhe të gjitha pyetjet që i parashtrori zotëri Agimi dhe kjo tash nga unë, në asnjërin nuk ishte të paktën e sigurt me thënë po ose jo, por u përgjigje se nuk jam e sigurt, skam qenë kurrë drejtorë, ndoshta nuk i di krejt përvojat, krejt praktikat, e po paragjykoj që në atë moment që bëhem kësi drejtori që s'kam informacione, a bëhet diçka a nuk bëhet, nuk e kisha mbajtur atë drejtori.

**Fatos Dibra** komentoi, duke thënë se këto kriterë që janë këtu në Rregullore, në një vend nga fundi iu ka lënë autorizimi Inspeksionit me u dhënë një afat të caktuar parkingjeve private për me i rregulluar, por pa i dhënë kriteret nuk mundesh me kërkuar asgjë prej tyre.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të Projektregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.**

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi Komitetit  
Agim Kuleta**



Faqe 5 nga 5